



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 24, datë 22.12.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin dhjetor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 22.12.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë!

E nderuar Kryetare!

Të nderuar nëpunës të Bashkisë Durrës!

Të nderuar Pjesmarrës!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin dhjetor.

Kjo mbledhje plenare e këshillit konsiderohet një ndër mbledhjet më të rëndësishme të vitit, pasi do të shqyrtojmë buxhetin e Bashkisë Durrës për vitin 2023, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2023-2025. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

Kryetar ke 33 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hyn me vonesë këshilltarët Mimoza Xhengo, Marjeta Milloshi, Silvana Kavaja, Artion Beqiraj)

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen. Kemi sot për shqyrtim e miratim **11 pika**. Po prezantoj pikat një e nga një si më poshtë:

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN DHJETOR 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA) PËR VITET 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2023
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2023
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2023-2025 NË BASHKINË DURRËS
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SI DHE KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERRAXHIA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE

	PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESIVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 71, DATË 12.07.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, PALLATIN NR.8, RRUGA “TELAT NOGA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1,4,5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 29 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 23’300’242.8 (NJËZETËETREMILION E TREQINDMIJË E DYQIND E DYZETË E DY E TETË ) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTUJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTOROMANOS - KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT, FAZA E PARË”

Atëherë përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 34 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit Kryetar. Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi në unanimitet ta kaloj në votim në këshillin bashkiak. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Meçi.

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 34 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj**: Faleminderit z. Kryetar. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave vendosi me shumicë votash pro miratimit të kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2024-2026 dhe buxhetit vjetor. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Bardhaj.

Atëherë komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj**: Edhe për këtë pikë Komisioni ynë vendosi pro miratimit të saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Bardhaj.

Komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

**Morena Boja** : Po.

**Ani Dyrmishi** : Po znj. Boja.

**Morena Boja** : Përsëndetje !

Unë kisha një koment përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit” lidhur me tarifën e parkimeve. Nga relacioni që na është vënë në dispozicion thuhet që vendparkimet publike me pagesë, pra të ardhurat që gjenerohen nga vendparkimet publike me pagesë mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë të kontraktuar nga

bashkia e Durrësit. Unë do të doja të dija që: Nga totali i të ardhurave, që mbliidhen nga parkimet sa përqind i shkon agjentit dhe cila është përqindja që mban bashkia e Durrësit ? Dhe mbase për të patur një efikasitet 100% në mbledhjen e të ardhurave që vinë nga parkimet publike : A do ishte më mirë që bashkia t'i menaxhonte vet këto parkime publike dhe jo me ndërmjetës siç është rasti i agjentëve tatimorë ? Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Po Kryetare.

**Emiriana Sako** : “Ne” normalisht kemi vendosur në paketë fiskale parashikimin për parkimin që do të ndërtohet në qytetin tonë. Aktualisht të gjitha parkimet publike janë pa pagesë në Durrës. Vendimmarrja merret në paketë fiskale meqënëse është e pandryshueshme gjatë gjithë periudhës së vitit. Parashikojmë që t'i kemi pa pagesë parkimet publike në qytetin e Durrësit deri në ndërtimin e investimit, që po bëjmë me Fondin Shqipëtar të Zhvillimit ku atje në bazë të marrëveshjes që kemi me “Të” do të vendosim dhe tarifatat përkatëse sa i takon parkimit në qytet. Faleminderit.

**Morena Boja** : Pra, kjo i referohet parkimit të ardhshëm që do të ndërtohet.

**Emiriana Sako** : Nuk kemi aktualisht asnjë parkim publik me pagesë.

**Morena Boja** : Ok, faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë komente të tjera përsa i përket pikës 3. Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstënim ? .....nuk ka.

Atëherë miratohet me 35 vota dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Drejtoreshës së Buxhetit znj. Valbona Qirjako.

**Valbona Qirjako (Drejtoresha Buxhetit)** : Përhëndetje !

Bashkia Durrës ka realizuar 8 dëgjesa publike për buxhetin e vitit 2023, si dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Ato janë prezantuar në Njësitë Administrative: Manëz, Ishëm, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, nr.4 dhe nr.6 dhe një dëgjese me biznesin ku është bërë prezantimi i paketës fiskale për vitin 2023.

❖ **BUXHETI I VITIT 2023 DO TË JETË 3.94 MILIARD LEKË, 7% më shumë se viti 2022**

Burimet e këtij buxheti:

1. 53.7% nga taksat dhe tarifatat vendore që parashikohen të jenë në vlerën 2,12 miliard lekë.

2. 44% nga transfertat e Qeverisë, Trasferte e pakushtezuar dhe transfertat sektoriale / 1,65 miliard lekë
3. 0,5% nga fondet e trashëguara nga viti 2021 në vlerën 100 milion lekë. Parashikimi për fondet e trashëguara është paraprak, të definuar do ta kemi në fund të muajit janar.

❖ Për vitin 2023 janë buxhetuar 17 programe buxhetore nga 20 që janë gjithsej, sipas klasifikimit të ri buxhetor që fillon në vitin 2023.

#### ❖ **PROGRAMET BUXHETORE PRIORITARE PËR VITIN 2023 :**

1. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE
2. ARSIMI
3. MENAXHIMI I MBETJEVE
4. SHËRBIMET SOCIALE DHE STREHIMI
5. SPORTI, KULTURA, RINIA

#### **1. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE**

- Fondi për investime për infrastrukturë rrugore për vitin 2023 do të jetë 305,8 milion lekë.
- Projektet kryesore ku do të ndërhyhet gjatë vitit 2023 janë: “Rehabilitim Rruga e Dëshmorëve, segmenti nga kryqëzimi me rrugën Mujo Ulqinaku tek Stacioni i Trenit” dhe “Rehabilitim i Shëtitores Taulantia (Loti III)”
- Fondi për rikonstruksione rrugësh në NJA Sukth, Ishëm , Rrushbull, Katundi i Ri, do të jetë në total 70 milion lekë, kurse në qytet 50 milion lekë me të cilin parashikohen të rikonstruktohen rreth 1900 ml rrugë.
- Fondi në dizpozicion të Ndërmarrjes Rruga për blerje asfalti është planifikuar në vlerën 45 milion lekë ose 10 milion lekë më shumë se viti 2022 dhe parashikohet të asfaltohen rreth 24 mijë metra katror sipërfaqe në segmente rrugore apo kuartalla.
- Do të vazhdojmë përmirësimin e sinjalistikës rrugore me një fond prej 22 milion lekë.
- Do të vazhdojmë mbjelljen e pemëve të reja. Fondi për këtë qëllim për vitin 2023 do të jetë 35 milion lekë, pra parashikojmë mbjelljen e rreth 3000 pemëve të reja. Gjatë vitit 2022 u mbollën 2120 pemë dhe 1530 janë ende në proces mbjellje.
- Gjatë vitit 2023 do të fillojë rehabilitimi i zonës që preket nga zgjerimi territorial i varrezave të Qytetit të Durrësit.
- Do të vazhdojmë me rehabilitimin e ndriçimit të akseve të rrugëve me një fond total prej 60.7 milion lekë. Gjatë vitit 2022 u rehabilituan me ndriçim 13255 ml, në 2023 parashikohen të rehabilitohen 8700 ml.
- Do të vazhdojmë me mobilimin e hapësirave publike me stola e kënde lojrash me një fond total prej 6 milion lekë.
- Do të ndërhyjmë për rehabilitim të infrastrukturës në shërbim të bujqësisë me një fond total prej 30 milion lekë.

## 2. ARSIMI

### **Buxheti për arsimin zë 21% të buxhetit total.**

- Shtohen 2 kopshte me ushqim në 2023, pra do të kemi gjithsej 12 kopshte me ushqim.
- Rreth 90 fëmijë në kopshte do të përfitojnë nga lehtësitë fiskale që do të aplikohen për nënat beqare ose kryefamiljare, si dhe familjet në nevojë lidhur me pagesat e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet.
- Edhe për vitin 2023 do të vazhdojmë të shpërblejmë financiarisht rreth 100 nxënës të klasave të nënta me notë mesatare 10.00 me një fond prej 2 milion lekë.
- Do të vazhdojmë të trajtohen me shpërblim financiar me një fond total 2 milion lekë nxënësit ekselent të shkollave të mesme, të cilët renditen në 100 vendet e para të maturës shtetërore dhe fituesit e tre vendeve të para të olimpiadave kombëtare, mesatarisht 35 nxënës në vit.
- Taksa e përkohshme e arsimit do të përdoret në funksion të plotë të kopshteve, për ndërtim godina të reja kopshtesh, si dhe rikonstruksion.

### **Investimet në arsim:**

- Për vitin 2023 fondet nga të ardhurat e Bashkisë që do të vihen në dispozicion për investime në arsim kapin shifrën 300 milion lekë, kurse në total për periudhën afatmesme 2023-2025 kapin vlerën 1.14 miliard lekë. Parashikohet që të ndërhyhet në 9 objekte arsimore.
- Gjatë vitit 2023 do të fillojnë punimet për ndërtimin e katër godinave të reja arsimore e konkretisht:
  - dy shkolla të reja 9 vjeçare: "Met Hasa" dhe godinë e re ku do bashkohen 2 shkollat "Vasil Ziu" dhe "Nënë Tereza"
  - shkolla fillore bashkë me kopshte pranë shkollave "Jusuf Hoti" dhe "Besnik Hidri"
- Do të fillojnë punimet gjatë vitit 2023 për rikonstruksion te 5 institucioneve arsimore:
  - Kopshti në fshatin Shkallë në Nj.A. Manëz
  - Qendra Kulturore e Fëmijëve
  - Shkolla 9 vjeçare "Demokracia"
  - 2 shkolla te mesme: "Besnik Hidri" dhe "Dom Nikoll Kacorri"
- Do të pajiset Shkolla e muzikes "Jan Kukuzeli" me vegla muzikore rreth 87 copë.

## 3. MENAXHIMI I MBETJEVE

- Buxheti për menaxhimin e mbetjeve për vitin 2023 parashikohet në vlerën 961 milion lekë dhe renditet i pari për nga pesha specifike në buxhet, zë 28 % të buxhetit.

- Ky buxhet do të financohet nga të ardhurat nga tarifa e pastrimit në masën 35 %, nga transfertat e Qeverisë për kontratën e depozitimit të mbetjeve në landfill në masën 25% dhe pjesa tjetër nga taksat e tarifave të tjera.
- Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 parashikohen të jenë 350 milion lekë më shumë ose 12 % më shumë se parashikimi për 2022.
- Edhe për vitin 2023 do të vazhdojë zëvendësimi i kontenerëve të dëmtuar e amortizuar, si dhe shtimi i numrit të kontenerëve në të gjithë territorin e Bashkisë me një fond total prej 36 milion lekë me rreth 800 kontenerë mbetjesh të rinj. Gjatë vitit 2022 janë vendosur 760 kontenerë mbetjesh

#### **4. SHËRBIMET SOCIALE DHE STREHIMI**

- Gjatë vitit 2023 do të hapim një qendër të re Multifunktionale në qytet .
- Fondi për mbështetje financiare për kategoritë e familjeve të përjashtuara nga skema e NE për vitin 2023 do të jetë 6 milion lekë ose 50% më i madh krahasuar me vitin 2022.
- Do të vazhdojmë të mbështesim 5 Qendrat sociale me fond total 44,39 milion lekë.
- Subvencionojmë komisionin e pagesës PAK për 3600 persona .
- Do të mbështesim 130 familje në nevojë me bonus qeraje.
- Do të subvencionojmë tepricat mbi interesin 3% të kredisë së lehtësuar për strehim për 79 familje përfituese.
- Do të mbështesim nga të ardhurat e Bashkisë me bonus qeraje familjet me banesa të dëmtuara nga tërmeti, me një fond total prej 100 milion lekë.
- Do të vazhdojmë mirëmbajtjen e banesave sociale, si dhe do të bëhet riparimi i ashensorëve dhe sistemit hidraulik të tyre.

#### **5. SPORTI, KULTURA, RINIA**

- Gjatë vitit 2023 do të mbështesim Klubin e Shumësporteve me një fond total prej 59.5 milion lekë për financimin e 45 sportistëve të nivelit të lartë , bashkë me 15 trajnerët e tyre me trajtim ushqimor 62500 lekë /muaj, si dhe 64 sportistë të tjerë dhe 19 trajnerët e tyre me një trajtim prej 20000 lekë /muaj. Pra në total 143 veta.
- Do të ngrihet një Qendër Rinore Multifunktionale në bashkëfinancim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë.
- Do të financojmë projekte sportive për të rinjë në bashkëpunim me këshillin rinor si : kampionati i basketbollit 3x3 ndërmjet shkollave, ku do të përfshihen 208 lojtarë.
- Do të mbështesim financiarisht projekte për promovimin e qytetit dhe objekteve të trashëgimisë kulturore me një fond total prej 7,5 milion lekë.

Ju faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Qirjako.

I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.



**Pamela Bardhaj:** Edhe për këtë pikë Komisioni ynë vendosi pro miratimit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2023. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Bardhaj.

Atëherë komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, ka nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit.

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim dhe pikën 5-së, që është për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore. Ky plan vendor përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Janë konkretisht:

- Avancimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- Avancimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.
- Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për të gjitha llojet e kategorive.

Ky plan veprimi është një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Durrës në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve të të gjitha moshave dhe nga të gjitha grupet e shoqërisë.

Dhe në këtë mënyrë dhe në këtë këndvështrim Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale ra dakort që ta kaloj për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Meçi.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj.Jolanda Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj** : Përshëndetje Kryetar!

Edhe Komisioni i Arsimit Kulturës u mbledh dhe unanimisht e mori vendimin për ta kaluar këtë pikë të rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Mustafaraj.

Komente përsa i përket pikës 6, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin për **pikën 7** të rendit të ditës, i japim fjalën Znj. Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj** : Edhe për këtë pikë të rendit të ditës Komisioni u mbledh dhe unanimisht e mori vendimin që kjo pikë të kalojë në rendin e ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Mustafaraj.

Komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në **pikën 8** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullore dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Faleminderit Kryetar. Përshëndetje të gjithëve.

Komisioni i Rregullore dhe Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim pikën 8, propozon unanimisht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Gjithashtu dhe Komisioni ynë unanimisht vendosi për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani**: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën 8 të rendit të ditës dhe vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 9**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni i Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim dhe pikën 9 propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe Komisioni ynë unanimisht ka votuar miratimin e kësaj pike.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani:** Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës votoi pro kalimit në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 10**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Po edhe për pikën 10, për miratimin e listës së 29 familjeve përfituese të subvencionimit të qirasë, të mbetura të pastreha, si pasojë e shembjes së banesave të tyre, Komisioni ynë votoi unanimisht për kalimin në votim në mbledhjen e sotme.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Komente përsa i përket pikës 10, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka.

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Edhe për pikën 11 Komisioni ynë, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj:** Komisioni jonë është dakort për këtë pikë.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përse i përket pikës 11, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 11 dhe e fundit e rendit ditës.

**Diskutime :** Ka kërkuar fjalën znj. Boja.

**Morena Boja:** Atëherë, pyetja ime lidhet me një ankesë të një qytetari, i cili kërkon të dijë se pse është s'kualifikuar nga përfitimi i grantit DS3 të tërmetit për shkak të nënshtetësisë. Ai deklaron se është një shtetas kosovar, por që ka një leje qëndrimi të rregullt me banim në lagjjen nr.13 në Durrës dhe deklaron se është i vetmi nga godina, pra nga pallati që nuk ka përfituar grantin DS3. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Nga stafi bashkisë ?

**Ermal Pronjari (Koordinator i Zyrës së Posaçme të Rindërtimit):** Përshëndetje.

Shtetasit me kombësi të huaj, që nuk kanë vendbanimin e zakonshëm ditën e fatkeqësisë natyrore nuk mund të jenë përfitues, pasi këtë e përcakton dhe Akti Normativ nr.9, neni 5 pika 3. Pra, për të përfituar nga grantet e rindërtimit dhe tek VKM nr.5, duhet të bëj aplikimin online dhe duhet dorëzuar certifikata familjare e personave. Zakonisht certifikata që dorëzohej është e Republikës së Shqipërisë.

**Morena Boja:** Në zbatim të aktit normativ përkatës dhe subjektet përfitues, për aq sa kam lexuar nuk shkruhet që shtetasit e huaj përjashtohen. E para ka certifikatën e pronësisë, e dyta ka aplikimin dhe e treta ka leje qëndrimi. Nuk i di këto ligjet e emigracionit, pra deri në çmasë e

mbrojnë këtë person që ka leje qëndrimi, por duhet të përfitoj nga granti i rindërtimit, pasi dhe lejen e qëndrimit e ka marrë nga institucionet shtetërore.

**Ermal Pronjari** : Atëherë dhe njëherë Akti Normativ nr.9, pika 3 thotë, po e citoj : “...vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdoret si vendbanim i zakonshëm”. Pra, ai nuk ka qenë banues, mund të ketë shtëpi tjetër, qytet tjetër, shtet tjetër.

**Morena Boja**: Ok, faleminderit.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit.

I jap fjalën znj. Sako.

**Emiriana Sako**: Faleminderit të gjithëve. “Ne” kemi marrë një mbështetje maksimale nga Këshilli Bashkiak. Gjej rastin që meqenëse jemi në mbledhjen e fundit dhe në muajin dhjetor t’Ju uroj festa të gëzuara dhe të takohemi sërish në janar të vitit që vjen. Faleminderit .

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit të gjithëve.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur .

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 13 (trembëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i procesverbalit**: Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit** :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI